

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Goditet organizata kriminale shqiptare në Spanjë: Sekuestrohen 2.7 ton kokainë
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392341.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:40:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 19:28:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 19:27:00 UTC → 17 shtator 2026, 19:29:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	49f98e3dbdf5c7aa2ad544fde3730bf801a65cb8d7eb311969e3a64d44560676
TEKSTI	ce299dc52701f548ccfa8b0d20bef1e093e4f60baf06238c43e75b647a9f2415
PAMJA	a13a2af9d6b6187d0048ff58b8bda4aa6b7674f7cbf00152a6925937cf07ec44

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3cc2b49ac9be805799e033c08fe793d7f1ba68b01f8d044ac0e6099878aed0bd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b36d3d1202e685b83ffc611c8f22a5defe9644c370970134944b31e37e025b7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3cc2b49ac9be805799e033c08fe793d7f1ba68b01f8d044ac0e6099878aed0bd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Goditet organizata kriminale shqiptare në Spanjë: Sekuestrohen 2.7 ton kokainë

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 17.09.2026, 21:28

Share



Policia Kombëtare e Spanjës ka ekzekutuar një superoperacion, duke shkatërruar një nga organizatat më të rrezikshme kriminale me origjinë shqiptare, e cila vepronte kryesisht në zonën e Costa del Sol dhe kishte ngritur bazën e saj logjistike në Katalonjë. Ky rrjet, që sipas autoriteteve kishte frymëzuar edhe serialin e njohur "Marbella", shërbente për magazinimin dhe shpërndarjen e sasive masive të kokainës në drejtim të tregut evropian.

Bilanci i këtij operacioni të madh përfshin arrestimin e 15 personave (ku 12 prej tyre janë lënë në qeli nga gjykata), si dhe sekuestrimin e 2.7 tonëve kokainë, 800 gramë lëndë narkotike e llojit "tusi", dy armëve të zjarrit dhe 29 automjeteve luksoze.

Si funksiononte rrjeti kriminal dhe logjistika e drogës?

Hetimet intensive, të nisura që prej vitit 2025, zbuluan se lënda narkotike mbërrinte nga Kolumbia përmes zonës së Campo de Gibraltar. Për të shmangur rrezikun, grupi përdorte vila luksoze të marra me qira afatshkurtër për të magazinuar drogën fshehurazi përpara se ta shpërndante. Një nga goditjet më të mëdha u realizua në një vilë në Sant Just Desvern, pranë Barcelonës, ku u sekuestruan vetëm aty 1.351 kilogramë kokainë.

Për transportimin e lëndës narkotike në distanca të gjata, organizata përdorte makina të fuqishme dhe luksoze. Kolonat e automjeteve udhëtonin deri në 2,000 kilometra në ditë, duke fluturuar në autostrada me shpejtësi mbi 200 km/h me qëllim që t'i shpëtonin survejimit dhe ndjekjes policore.


Kontrollet dhe pasuritë e sekuestruara

Operacioni u shtri në disa qendra dhe rajone kyçe të Spanjës, përfshirë Málaga, Estepona, Marbella, Churriana, Alicante dhe Barcelona. Përveç lëndës narkotike dhe automjeteve, gjatë kontrolleve autoritetet spanjolle konfiskuan gjithashtu shuma të konsiderueshme parash cash, bizhuteri të shtrenjta, orë luksoze dhe asete në kryptoaktive, duke i dhënë një goditje të rëndë strukturës financiare të këtij rrjeti kriminal.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.